

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo

{ EMBED
Word.Picture.8
}
UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

UNMIK/REG/2003/3
30 JANAR 2003

RREGULLORE Nr. 2003/3

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut Nr.2002/4
MBI TATIMIN NË TË ARDHURA PERSONALE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) më 10 Qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 Korrik 1999 mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me shpalljen e Rregullore së UNMIK-ut Nr.2002/4 më 20 Shkurt 2002 Tatimi në të Ardhura Personale në Kosovë,

Duke vepruar me kërkesën e Qeverisë dhe duke kërkuar këshillën e Këshillit Ekonomik dhe Fiskal,

Për qëllime të ndryshimit të Rregullore së UNMIK-ut Nr.2002/4 me qëllim të rregullimit të shkallëve të tatimit në të ardhura dhe duke pritur paraqitjen e legjislacionit gjithpërfshirës të të ardhurave personale që do të mbulojë të gjitha burimet e të ardhurave,

Me anë të kësaj shpall me sa vijon:

Neni 1
Ndryshimi

1.1 Nëpërmjet kësaj ndryshohet neni 6.2 i Rregullore së UNMIK-ut Nr.2002/4 dhe formulohet si vijon:

“6.2 Për periudhën tatimore 2003 dhe periudhat tatimore pasuese, tatimi në të ardhura do të aplikohet mbi të ardhurat e tatueshme sipas shkallëve vijuese:

- (a) Për të ardhurat e tatueshme deri në 960 euro, në shkallë prej zero përqind (0%);

- (b) Për të ardhurat e tatueshme në mes 960 euro e 3000 euro, në shkallë prej pesë përqind (5%);
- (c) Për të ardhurat e tatueshme në mes 3000 euro e 5400 euro, 102 euro plus dhjetë përqind (10%) e shumës mbi 3000 euro; dhe
- (d) Për të ardhurat e tatueshme mbi 5400 euro, 342 euro plus njëzet përqind (20%) e shumës mbi 5400 euro”.

1.2 Për qëllime të implementimit të nenit 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/4, të ndryshuar me këtë Rregullore, me këtë neni 7.2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2002/4 është ndryshuar dhe formulohet si vijon:

“7.2 Një punëdhënës i cili është punëdhënësi kryesor i të punësuarit do të mbajë në burim për periudhat e pagave për Janar, Shkurt dhe Mars 2003, një shumë ashtu si është paraqitur në tabelat e mbajtjes në burim të lëshuara nga Autoriteti Qendror Fiskal për periudhën tatimore 2002. Për periudhat pasuese të pagave, shuma që duhet mbajtur në burim do të përcaktohet në bazë të formulave llogaritëse të tatimit për mbajtje në burim që do të lëshohet nga Administrata Tatimore për periudhën tatimore të aplikueshme”.

Neni 2
Ligji i aplikueshëm

Kjo Rregullore do të zëvendësojë çdo dispozitë në ligjin e aplikueshëm që nuk është në përputhje me të.

Neni 3
Implementimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për implementimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do vlejë nga 1 Janari 2003.

Michael Steiner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm